



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:276702  
Datë: 27.02.2025  
Numri i dokumentit: 06910404

C.nr.1079/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.K., mësimdhënës në SHFMU "I.M." në Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Zahir Hamza, avokat në Prishtinë, me adresë rr. "Garibaldi", nr.13/8, 10000-Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, me objekt kontesti kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 539.00 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit G.K., mësimdhënës në SHFMU "I.M." në Malishevë dhe DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, t'ia paguaj paditësit të lartcekur për periudhën kohore 01.01.2022 deri më 30.11.2022 (gjithsej 11 muaj), shumën e përgjithshme prej 537.13 Euro (pesëqind e tridhjetë e shtatë Euro e trembëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 16.05.2024 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.
- II.** REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, për paditësin G.K., për periudhën kohore nga data 01.12.2022 e deri me datë 31.12.2022, në shumën prej 1.87 Euro (një Euro e tetëdhjetë e shtatë cent), si e pabazuar.
- III.** DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi G.K. mësimdhënës në SHFMU “I.M.” në Malishevë përmes së autorizuarit të tij Zahir Hamza, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë me datën 10.05.2024, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës në shkollën SHFMU “I.M.” në Malishevë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësit. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësi ka paraqitur padi përmes së cilës ka kërkuar që t’i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit të saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 27.01.2025, ku ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi lidhur me pagesën e inflacionit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive në bazë të nenit 35 pika 10 e kësaj kontrate si dhe kontrata e vitit 2021, për faktin se nuk kanë të dhëna për çka duhet të paguhet ky inflacion dhe sipas tyre nuk kanë prova konkrete nga Institucionet e Kosovës-BQK, çfarë rritje ekonomike ka pasur në Kosovë dhe se çfarë përqindje të inflacionit duhet paguar. Ka shtuar se padia është në tërësi e pa bazuar pasi kjo padi është bërë vetëm në bazë të supozimeve dhe nuk ka të bëjë asgjë me inflacion, pasi nuk ka të dhëna se ku duhet të mbështetet kjo përqindje e rritjes së inflacionit dhe kjo normë e kontratës kolektive nuk mund të zbatohet. Ka theksuar se e paditura e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi kontrata kolektive e arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur nga MASHT-i dhe kjo kontratë kolektive tanimë nuk është në fuqi, pasi palët të cilat e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe se i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT-i për SBASHK-un më dt. 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate për shkak të mungesës së bazës ligjore. Po ashtu ka shtuar se kjo padi ka arritur parashkrimin në bazë të nenit 352 dhe 353, par. 1 të LMD-së dhe se padia është e pasafatshme, pasi ky borxh është kërkuar që nga viti 2021, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2024 dhe se kontrata kolektive e vitit 2021 ka skaduar me dt.22.11.2022, dhe padia është paraqitur pas ndërprerjes së kontratës kolektive, andaj ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar sepse nuk ekziston asnjë bazë ligjore. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi G.K. është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në shkollën SHFMU “I.M.” në Malishevë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditësit G.K. është shuma prej 421.00 Euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga muaji janar i vitit 2022 deri në muajin nëntor të vitit 2022 (brenda kërkesës së paditësit) sipas përllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses e cila në vitin 2022 ka qenë 421.00 Euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 537.13 Euro, apo 48.83 Euro për muaj ( $421.00 * 11.6\% * 11 = 537.13$ ).

Duke qenë se mes palëve nuk ishte kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.01.2022 deri me datë 30.11.2022, në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e

aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim është tërësisht i pabazuar, pasi konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 16.05.2024, rezulton se për periudhën e pjesës së kërkesës së aprovuar nga data 01.01.2022 e deri më 30.11.2022 sa ka qenë Kontrata Kolektive në fuqi, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësi e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë.

Më konkretisht, me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 16.05.2024, në kuptim të nenit 369 të LMD-së ku theksohet se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*, gjykata vlerëson se në këtë rast është ndërprerë parashkrimi për periudhën e pjesës së kërkesës së aprovuar nga data 01.01.2022 e deri më 30.11.2022 dhe padia e njëjtë është paraqitur brenda afatit ligjor. Po ashtu, Gjykata pagën bazë të paditësit e ka llogaritur duke u bazuar në listën e pagave dhe kontratës së punës. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë më datë 16.05.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj paditësit.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata gjeti se pjesa e kërkesës për periudhën kohore nga data 01.12.2022 e deri me datë 31.12.2022 të kërkuar nga paditësja, vërtetohet fakti se paditësi kërkesën e tij e bazon në periudhën në të cilën nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021. Kjo duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik me numër 214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ku në pikën III përcaktohet që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e lidhur me datë 22.01.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datë 21.11.2022. Andaj në një rrethanë të tillë koha kur paditësi ka kërkuar kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.12.2022 e deri me datë 31.12.2022, është periudhë kohore kur Kontrata Kolektive Arsimit Kosovës numër 105 e datës 22.01.2021 nuk aplikohet, kjo pasi kontratës së lartcekur i ka pushuar efekti juridik pas datës 21.11.2022.

E për më tepër, gjykata përllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga muaji janar i vitit 2022, duke shtuar normën e inflacionit deri në muajin nëntor të vitit 2022, për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 104.00 Euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 Euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil

C.nr.1079/24, datë 27.02.2025

G j y q t a r j a  
Hatixhe Begaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.